D E K R E T
Nr.1632, datë 1.11.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7512, DATË 10.8.1991 "PER SANKSIONIMIN DHE MBROJTJEN E PRONES PRIVATE, TE NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE PRIVATE TË PAVARURA DHE PRIVATIZIMIT"

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Neni 2 i ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991, ndryshohet si vijon:

Personat fizikë dhe juridikë, shqiptarë ose të huaj, publikë ose privatë ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Neni 21 ndryshohet si vijon:

Personat fizikë a juridikë, shqiptarë ose të huaj kanë të drejtë të blejnë truall për ndërtim, t'ua tjetërsojnë këtë të drejtë të tretëve dhe të marrin me qira truall në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 3

Neni 22 ndryshohet si vijon:

1. Kalimi i pronës shtetërore në pronë private drejtohet dhe organizohet nga Ministria e Privatizimeve. Kjo ministri përcakton kohën, radhën dhe mënyrat e kryerjes së privatizimit për të gjitha objektet që i nënshtrohen këtij procesi.

2. Dhënia me qira e pronës shtetërore bëhet nga organi që përfaqëson shtetin si pronar.

Neni 4

Neni 23 ndryshohet si vijon :

Kalimi i pronës shtetërore në pronë private bëhet nëpërmjet shitjes së saj me ankand, transferimit në publik të aksioneve, transferimit drejtpërdrejt të aksioneve personave fizikë a juridikë, vendas a të huaj, dhënies falas të aksioneve, si dhe në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme.

Vlerësimi i pronës shtetërore do të bëhet mbi bazë të akteve nënligjore të dala nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

Neni 25 ndryshohet si vijon:

Agjencia Kombëtare e Privatizimit si institucion buxhetor në varësi të Këshillit të Minístrave kryen procedurat e shitjes së pronës shtetërore sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 6

Nenet 10, 11, 12, 13, 16 dhe 24 të ligjit nr. 7925, datë 19.4.1995 dhe ligji nr.7653, datë 23.12.1992, shfuqizohen.

Neni 7

Dekreti nr. 1616, datë 20.9.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991 "Për

sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", shfuqizohet.

Neni 8

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

kUNDëRFIRMOHET

kRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE	PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Aleksandër Meksi	**Sali Berisha**